

YLBERI shpk

Adresa : Theken, Bulqizë

NIPT : K07729908J

Baza ligjore:

VKM Nr. 686, date: 29.7.2015, "Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore"

Ligjit Nr. 10 440, date: 07.07.2011, "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis", Shtojca II, Pika 2.2 Minierat nëntokësore

"Ylberi" sh.p.k.

RAPORTI VNM per PROJEKTIN:

"SHFRYTEZIM I MINERALIT TE KROMIT"

"Maja e Kunorës", Klos, Burreldiber

Hartoi:

Remzi Pupli

PERMBAJTJA E LENDES

- a. Një përshkrim i shkurtër i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi;***
- b. Informacioni për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij;***
- c. Një identifikim i ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;***
- d. Një përshkrim i shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;***
- e. Informacioni për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara;***
- f. Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;***
- g. Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;***
- h. Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;***
- i. Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë);***
- j. Kopje të certifikatës së specialistit/ëve për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor, që ka hartuar raportin paraprak të VNM-së.***

a. Një përshkrim i shkurtër i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi;

Flora

Zona me interes për shfrytëzim (referuar hartës së studimit të florës) paraqitet relativisht pak e mbuluar me bimësi dhe e ekspozuar ndaj agjentëve klimatikë. Në shpatet me pjerrësi më të madhe se 50 % bimësia është e pazhvilluar dhe e rrallë. Nëpër rrjedhat e proskave sezonale ku akumulohen depozitime dhe sedimente të shkrufta vërehen individë të rrallë të dushqeve dhe dëllinjës së kuqe. Zhvillim më i plotë i shoqërimeve shkurre vërehet në shpatet me pjerrësi nën 30%, zona në të cilët janë akumuluar depozitimet e shkrufta proluviale.

Në disa zona të veçanta gjenden formacione me pisha të buta të mbjella nga Shërbimi Pyjor rreth viteve 70-80. Këto formacione janë të dendura dhe të dëmtuara rëndë nga *procesionaria*. Kjo zonë, si pasojë e diversitetit ekologjik ka një variacion të lartë habitatesh që u përkasin tre brezave vegjetacionalë:

1. Brezi i vegjetacionit të pyjeve gjethegjera termofile
2. Brezi i vegjetacionit të grumbujve gjethegjere ose mikse mezofile
3. Brezi i vegjetacionit të kullotave alpine.

Shoqërimet bimore ekzistuese të zonës së studimit

Sipas klasifikimit të përgjithshëm fitosociologjik të bimësisë së Shqipërisë shoqërimet bimore të zonës në studim i përkasin asaj të dushqeve gjetherënës. Ky brez shtrihet mbi brezin e shkurreve mesdhetare deri në lartësinë 1000m.

Shoqërimi *Quercetum cerris-frainetto*

Zona në studim mbizotërohet nga vegjetacioni i dushkajave, një grupim bimor i cili përfaqëson pyje gjethegjera të përhapura përgjithësisht në brezin para malor dhe malor.

Ky shoqërim bimor gjendet më shpesh në toka të kafenjta tipike. Speciet më karakteristike të këtij shoqërimi janë shparthi (*Quercus frainetto* Ten.) dhe qarri (*Quercus cerris* L.), të cilët janë edifikatorë të fitocenozës dhe lloje dominante njëkohësisht, të cilët dallohen për shkallën e lartë të sasimbulesës e dominancës.

Dushkajat e formuara nga dushqe mezofile dhe gjysëmmezofile janë pyje me hijezim më të madh se sa ato të formuara nga dushqet kserofile kështu që edhe flora e tyre është më pak e pasur. Përbërja floristike ndryshon sipas tipit të pyllit, përbërjes së tokës, lartësisë, kundërdrejtimit, shkallës së ndriçimit etj., por një numër i konsiderueshem specimesh janë të përbashkëta.

Sipërfaqja në studim mbulohet në 50% të saj nga llojet mezofile të qarrit *Quercus cerris*, shparthit *Q.*

Frainetto, shoqëruar me dëllinjën se kuqe

Juniperus oxycedrus dhe me përfaqësim më të rrallë ato të shkozës

Carpinus orientalis Mill,

frashërit *Fraxinus ornus* L, panjës *Acer campestre*, pishës së butë *Pinus*

sp (sb. pinea) dhe drizës *Paliurus aculeatus* etj.

Shoqërimi shfaqet përgjithësisht i dëmtuar me pjesë të caktuara në stadin e filizërisë. Në çeltirat e krijuara pas prerjes së dushkut përhapet masivisht dëllinja e kuqe *Juniperus oxycedrus*, ndërsa në sipërfaqet e hapura livadhore evidentohen zhvillimi i qumështores *Euphorbia myrsinites*. Llojet e tjera

që takohen në hapësirat e hapura të zonës së studimit janë manaferra *Rubus ulmifolius Schott*, fiku i egër *Ficus carica*, trëndafili i egër *Rosa canina L*, driza *Paliurus spina-christi Mil*, murrizi *Crataegus monogyna*.

Për nga përbërja floristike e katit të florës barishtore përfaqësohet nga llojet: *Potentilla erecta*, *Lychnis coronaria L*, *Buglossoides purpurocaerulea (L.)I.M.Jhons.*, *Clinopodium vulgare L*, *Brachypodium pinnatum (L.)P.B.*, *Lathyrus niger (L.)Berhn L*. *Stachys germanica L*, *Dactylis glomerata L*, të cilat janë specie karakteristike të aleancës *Quercion frainetto-cerris* por të përhapura janë edhe llojet e *Achillea millefolium L.*, *Bellis perennis L*, *Ajuga reptans*, *Geranium robertianum*.

Lista e llojeve floristike më të zakonshme në zonën e studimit

1. *Quercus frainetto Ten.*
2. *Quercus cerris L.*
3. *Pinus sp (sb. pinea)*
4. *Juniperus oxycedrus*
5. *Fraxinus ornus L,*
6. *Acer campestre*
7. *Carpinus orientalis Mill.*
8. *Buxus sempervirens*
9. *Euphorbia myrsinites*
10. *Pteridium aquilinum*
11. *Rubus ulmifolius Schott.*
12. *Rosa canina L.*
13. *Paliurus spina-christi Mill*
14. *Crataegus monogyna*
15. *Paliurus aculeatus*
16. *Ficus carica*
17. *Buglossoides purpurocaerulea (L.)I.M.Jhons.,*
18. *Clinopodium vulgare L.,*
19. *Brachypodium pinnatum (L.)P.B.,*
20. *Lathyrus niger (L.)Berhn ,*
21. *Stachys germanica L*
22. *Dactylis glomerata L*
23. *Achillea millefolium L.*
24. *Bellis perennis L,*
25. *Ajuga reptans,*
26. *Geranium robertianum.*

Ne zonen e shfrytezimit nuk ka ndonje lloj ose specie flore apo faune qe mbrohet me status te vecante .

Flora dhe fauna lokale nuk do te preket nga shfrytezimi, mbasi siperfaqja e objekti eshte pothuajse e zhveshur nga bimesia Zona ne te cilen eshte objekti paraqet nje peisazh te zakonshem, me nje relief te thyer malor, te zhveshur e nuk gezon ndonje status mbrojtje te vecante ne lidhje me floren e faunen. Bimesia e zones ku eshte objekti ka natyre me ndonje prani shkurre te larta, njekohesisht me larg objektit ka dhe pishe, ah etj. karakteristike te zonave te tilla, ne vartesi te struktures se

tokes e kushteve klimaterike. Theksojme se ne keto vite tranzicioni kjo zone ka shpyllezuar thajse mbi 70 % masivet pyjore gje e cila duket qarte ne mjediset perreth edhe ketij teritori ku do te zhvillohet kjo veprimtari. Ne zonen afer nuk ka kullota malore, por ato jane larg teritorit qe mendohet per shfrytezim. Fauna eshte e pasur me specie te ndryshme nga ujku, dhelpra., lepuri etj, krahas zvarranikeve, zogjve e brejtes te tjere, por edhe keto ndodhen larg zones se shfrytezimit.

- **Përshkrimi i zonave te mbrojtura pranë vendit ku propozohet te zbatohet projekti përfshi edhe monumentet natyrore te mbrojtura me ligj;**

Prane kesaj siperfaqe per shfrytezim nuk kemi zona te mbrojtura me status te vecante, apo monumente natyre.

b. Informacioni për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij;

Nga pikpamja hidrologjike dhe hidrografike objekti i kerkuar ndodhet ne kushte te mira. Nuk vihen re burime natyrale ujrash. Rrjeti hidrografik është pak i zhvilluar. Në pjesën perendimore kalon përroi Zalli i limones që derdhet e përroin e Kotës e të Batrës, ndërsa në pjesën lindore kalon një përroskë që derdhet në përroin e Krastes.

Objekti ndodhet ne një zone tektonikisht te qete, me përroska ne ane te tije. Nga studimet e pjeshme hidrogjeologjike takojmë dy tipe ujërash nëntokësore:

1. Ujra te çarjeve te shkëmbinjve ultrabazik.
2. Ujra te depozitimeve kuaternare.

Ujërat e çarjeve te shkëmbinjve ultrabazik takohen ne faqet e punimeve minerare te kërkim-zbulimit me debit te vogël 0.1-0.5l ne sekondë. Ujërat nëntokësore te çarjeve kimikisht janë te tipit hidrokarbonat magneziumi. Ujërat e depozitimeve kuaternare dalin ne forme burimesh me debit te vogël dhe janë direkt ne varësi te kushteve atmosferike. Nga vrojtimit e kryera ne vendburim mund te themi se kushtet hidrogjeologjike dhe hidrokimike, nuk paraqesin asnjë rrezik për shfrytëzimin.

c. Një identifikim i ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;

1-Ndikimet ne popullsi

Vendi ku do te zhvillohet aktiviteti eshte relativisht larg qendrave te banuara rreth 2km dhe nuk sjell shqetesime per ta vecse rrit mundesine e punesi it. Ky aktivitet do te sjell te mira e sherbime jo vetem per investitorin por edhe per komunitetin.

2-Ndikimet ne klime

Gjate zhvillimit të aktivitetit nuk priten ndryshime të dukshme klimaterike, si në drejtim të permiresimit ashtu edhe në atë të perkeqesimit të saj. Nuk do të ketë ndryshime në temperaturë, në drejtim të erës, në sasinë e reshjeve. Pra kryerja e këtij aktiviteti nuk ndikon fare në kushtet klimaterike të kësaj zone.

3-Ndikimet në biodiversitet

Objekti ndodhet në zone minerare, e cila bën pjesë në planin minerar shtetëror për zhvillimin e industrisë minerare. Nga ky aktivitet nuk do të vijë shqetësime si humbje të bimesise, prishje habitatesh, ekosistemesh etj.

4-Ndikimet në ujë

Duke qenë se objekti ndodhet larg burimeve ujore sipërfaqesore si lum, perrua, liqen etj, nuk kemi ndikime në ujë. Po kështu edhe për burimet nëntokesore ky aktivitet nuk përben rrezik, pasi ujerat nuk do të derdhen për asnjë arsye të patrajtuar dhe pa kriter në mjedisin përreth.

5-Ndikimet në tokë

Nga zhvillimi i aktivitetit nuk kemi humbje të tokës, rreshkitje të dherave, erosion etj. Asnjë lloj mbetjeje nuk do shkarkohet në tokë pa u trajtuar me parë dhe pa kriter.

Gjate zhvillimit të aktivitetit nuk gjenerohen mbetje të ngurta të cilat të përbejnë rrezik për ndotjen e tokës. Sterilet që do të grumbullohen do të dergohen direkt në fabrikën e pasurimit të kromit Bulqize.

6-Ndikimet në ajër

Gjate zhvillimit të aktivitetit nuk do të kemi emetime të gazeve të demshëm apo të erërave të rënda në mjedisin përreth, pasi nuk kemi të bëjmë me linjë prodhimi ku kemi produktë perfundimtar.

d. Një përshkrim i shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;

Ky raport hartohet mbi bazën e parimit të mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve vendim-marrese për licensimin ose jo të aktiviteteve të ndryshme të cilat mund të kenë ndikim në mjedis.

Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë veprimtaritë të cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet baze të mbrojtjes së mjedisit të cilat janë:

- Parimet e mbrojtjes së mjedisit
- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësive së ndërsjelle dhe bashkëpunimit
- Parimi "Ndotesi paguan"

- Parimi i se drejtes per informim dhe i pjesemarrjes se publikut
- Parimi i nxitjes se veprimtarive per mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nenkupton mbrojtjen e integruar te perberesve te mjedisit nga ndotja, si vegmas, ashtu dhe ne kombinim, duke pasur parasysh nderveprimet ndermjet tyre dhe qysh ne fazen e planifikimit te zhvillimit te nje territori te caktuar.

- Mbrojtja e Perbersve te mjedisit klasifikohet ne:
- Mbrojtja e ajrit
- Mbrojtja e ujerave
- Mbrojtja e tokes
- Mbrojtja e natyres
- Ndryshimet klimatike

Llojet e ndikimeve kryesore ne mjedis dhe vleresimi i tyre

5.3.1. Ndikimet kryesore ne mjedis

Nga ndertimi dhe funksionimi i nje aktiviteti konsistojne ne vija te pergjithshme si me poshte:

- Emetimet ne ajer dhe zhurmat
- Shkarkimet ne uje
- Ndikimi ne toke
- Ndikimi ne flore/faune
- Mbetjet e prodhuara
- Ndikime social-ekonomike
- Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara
- Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor
- Ndikim ne peizazhin e zones
- Ndikim ne ndryshimet klimatike

Vleresimi i ndikimit ne mjedis i nje projekti te propozuar zhvillimi, eshte vleresimi i ndikimeve te rendesishme, te mundshme, te asaj veprimtarie ne mjedis. Gjate procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis kryhen identifikimi, pershkrimi dhe vleresimi ne menyren e duhur i ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie, te referuar ne paragrafin e mesiperm, duke percaktuar efektet e mundshme te drejtperdrejta dhe jo te drejtperdrejta mbi token, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimen, shendetin e njeriut, floren dhe faunen, peizazhin natyror, pasurite materiale, trashegimine kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre te ndersjellta.

Vleresimi i ndikimit ne mjedis zbaton parimin e parandalimit qe ne fazen e hershme te planifikimit te projektit, me qellim shmangien apo minimizimin e efekteve negative ne mjedis, permes harmonizimit dhe pershtatjes se saj me kapacitetin bartes te mjedisit.

Vleresimi i ndikimit ne mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjese e pergatitjeve per planifikimin e nje projekti zhvillimi dhe para kerkimit te lejeve perkatese te zhvillimit. Ne baze te ketij vleresimi, institucioni pergjegjes per mjedisin, merr ne shqyrtim dhe kryen verifikimet perkatese per lejimin ose jo te zhvillimit te nje aktiviteti te caktuar. Institucioni pergjegjes per shqyrtimin e dokumentacionit dhe aprovimin ose jo te lejes mjedisore para vendimarrjes se tij, konsultohet edhe me institucione te tjera te cilat kane lidhe te drejteperdrejte ose jo te drejtperdrejte me projektin ose ndikohen nga ky i fundit. Konsultimi eshte edhe me i gjere me publikun e ndikuar dhe palet e interesit.

Nje pershkrim i shkurter per shkarkimet e mundshme ne mjedis:

- Shkarkimet ne mjedis nga zbatimi i ketij projekti, ne terma te shkurtuara do te ishte: Shkarkime ne ajer nga aktiviteti ndertimor. Pluhurat fluturues te kantierit te ndertimit, gazet e mjeteve te ndertimit dhe te transportit.
- Shkarkime ne ujera nga ujerat e shiut nga kantieri dhe ujerat e zeza nga aktiviteti gjate shfrytezimit te kompleksit.
- Shkarkimet e mbetjeve te ngurta, mbetjet urbane nga aktiviteti human dhe dheu qe do te largohet nga siperfaqja qe do te ndertohet.
- Zhurmat e punimeve ndertimore, nga mjetet e renda, nga transporti, por edhe gjate funksionimit nga aktivitetet me muzike ne oret e vona, nese do te zhvillohen.

1 Humbje e tokes per kullote

Siperfaqja e pergjitheshme qe do te zeje objekti gjate shfrytezimit eshte 0.15 km². Fenomenet qe mund te shfaqen gjate shfrytezimit te minieres, jane te ngjashme me ato te minierave te tjera dhe atyre qe jep literatura si zhvendosje, ulje etj.

2. Humbje e pjeresise se tokes

Humbja e pjeresise se tokes nga shfrytezimi nuk do e jete e konsiderueshme . Ne disa raste mund te vihen re ndikime te shfrytezimit ne siperfaqe

3. Ndotja e tokes nga rrjedhjet

Ne projektin e shfrytezimit jane percaktuar masa si rrjedhejen e ujrave qe dalin nga nentoka ashtu dhe per depozitimin e sterileve te ndryshme.

4. Ndotja e tokes nga mbetjet e ngurta

Sasi e sterileve te punimeve dhe seleksionimit do te jete rreth 51149 m³ te cilat do te depozitohen ne siperfaqen e caktuar per kete qellim . Ato perfaqesohen nga masa te shkriфта, qe nuk permbajne elemente ndotes per ambientin . Keto depozitime nuk jane fertile dhe nuk do te sherbejne per rigjenerim

5. Ndotja e tokes nga depozitimi i llumrave

Gjate shfrytezimit te objektit nuk parashikohet depozitime llumrash

6. Errozioni gjate hapjes dhe shfrytezimit te objektit minerar.

Ne projekt eshte parashikuar nje radhe dhe drejtimi i tille i shfrytezimi, qe ne kombinim me masat e tjera suplementare te mbushjes, sistemimit dhe trajtimit, parandalojne erozionin, shembjen dhe vithisjen e siperfaqes se tokes rreth saj.

7. Bimet e ujit

Ne zone ku do te ushtrohet aktiviteti i shfrytezimit nuk ka asnje lloj bime uji

8. Flora dhe fauna

Ne zonen e shfrytezimit nuk ka ndonje lloj ose specie flore apo faune qe mbrohet me status te veçante.

Flora dhe fauna lokale nuk do te preket nga shfrytezimi, mbasi siperfaqja e objektit eshte pothuajse e zhveshur nga bimesia

9. Trajtimi i ujrave

Teknologjia shfrytezimit te objektit parashikon perdorimin e ujit per shpimin e lagur dhe sperkatjen e stoqeve. Ujrat e reshjeve do te dekantohen ne gropa brenda zones se shfrytezimit. Rrjedhja e me tejshme e tyre do te behet ne perputhje me rrjedhen natyrale te tyre me ane te nje kanali ne ane te rruges se hapjes deri ne kanaline e rruges se poshtme

10. Zhurmat gjate punes se hapjes

Burimi kumuluar i zhurmave nga puna e njekoheshme e makinerive ne distance 7 m nga to, eshte 180 dB. Duke mare parasysh shprehjen e nivelit te intensitetit akustik te nje zhurme me relacinin me poshtem :

$$L = 10 \lg(I_1/I_0) \text{ ku}$$

L - Niveli akustik i zhurmes te marre ne konsiderate .

51

51

I1--Intensiteti akustik i zhurmave te kumuluar

I0- Intensiteti akustik i references

Vleresojme se niveli akustik i zhurmes ne rruge eshte me i ulet se ai i zhurmes se nje makine qe kalon ne te , praktikisht ai eshte 40-50 dB qe i pergjigjet kushteve te nje bisede me ze normal.

Analiza e frekuences te zhurmes te emetuar nga keto makineri dhe pajisje tregon tregon se ato ndodhen nen mesataren e frekuences 200-2000Hz , e cila e shte e pranueshme nga veshi i njeriut .

11. Pluhurat gjate procesit te punes

Me qene se projekti parashikon rrezimin e materialit me perdorim te LP formacionet jane relativisht te forta do te kete lirime pluhurash per kete parashikohet çpimi i lagur dhe sperkatja me dushe uji .

12.Ndikimi ne mjedis i produkteve te lendeve plasese

Gjate shfrytezimit te objektit parashikohet perdorimi i lendes plasese ne rreth 4.2 ton /vit . Ne projekt

jane parashikuar te gjitha masat mbrojtese si per flakerimin e coprave , valen sizmike dhe zhurmat .

Ndikimi i perdorimit te lendes plasese do te jete i pakonsiderueshem .

13.Ndikim ne mjedis i gazeve te njeteve motorike

Gjate fazes se zbatimit te projektit nuk do te kete emetime te gazrave, lengjeve , mbetje toksike, helme te ndryshme dhe substanca te tjera te demshme te cilat mund te ndikojne negativisht ne shendetin e punonjesve, banoreve dhe mjedisin per rreth duke perfshire te gjitha llojet e bimeve dhe gjallesave te ndryshme

14.Prodhimi i mbeturinave dhe depozitimi i materialve qe krijohet gjate hapjes dhe shfrytezimit te objektit Gjate hapjes dhe shfrytezimit te objektit do te kete vetem depozitim paraprak te rreth 19000m3 sterile .

15. Pastrimi rregullimi dhe rigjenerimi i pejsazhit

Planifikimi i zones;

Per shmagen dhe parandalimin e erozinit, shembjes se siperfaqes dhe vithisjeve te ndryshme, ne projekt eshte percaktuar shfrytezimi harmonik dhe i kombinuar ne kohe dhe hapesire i zones ne tersi dhe daljeve te ndryshme te mineralizimit ne vecanti.

Gjate ushtrimit te aktivitetit dhe kryesisht ne vitet e fundit te tij, parshikohet trajtimi i te gjithes siperfaqes se shfrytezuar

Kjo siperfaqe e perfituar nga trajtimet e me siperme do te jape mundesi minmale per rikultivimin e bimeve dhe pemeve te ndryshme lokale, duke krijuar kushte per parandalimin e erozionit dhe permiresimit te pamjes se pergjitheshme te zones se shfrytezuar

Per parandalimin e erzoionit, shembjes dhe vithisjeve te ndryshme, ne zonen e shfrytezimit subjekti parshikon, cdo vit, te kryeje punimet e depozitimit dhe sistemimit:

Do te depozitohen hap pas hapi ne çdo vit mbetje te ndryshme te sterilive te punimeve te cilat

perbehen nga depozitime jo produktive, por qe mund te sherbejne per sistemime te ndryshme;

16. Demtime te siperfaqes nga operacionet e germimit

Gjate shfrytezimit do te kete germime ne siperfaqe ne nje siperfaqe prej 12 000 m² . Kjo siperfaqe do te mbushet me sterilet e zbulimit dhe ato qe do te dalin nga miniera nga punimet e ndryshme dhe seleksionimi me dore i mineralit te prodhuar

17. Ndikimi ne infrastrukturen e zones se objektit

Objekti gjate fazes se ndertimit dhe shfrytezimit te tij do te lidhet me rrugen e kzistues te pershkruar ne projekt

Transporti i materialit nga objekti i shfrytezimit dhe perpunimit ne destinacion do te behet me kamione 20 ton duke perdorur rrugen e permendur me siper .

Aktiviteti i transporti qe do te kryet nga subjekti i shfrytezimit nuk e rendon trafikun aktual ne rruge, mbasi numuri i kamionave qe do te kalojne ne te eshte i vogel .

18. Ndikim ne shendetin e njerezve qe punojne ne objekt dhe te banoreve per rreth.

Punonjesit qe do te jene prezent ne objekt gjate shfrytezimit te tij do te jene te mbrojtur nga mjetet personale mbrojtese kundra pluhurit dhe zhurmave te cilat do te jene te kufizuar vetem brenda zones seshfrytezimit.

Si rrjedhoje e projektit te zhvillimit te shfrytezimit te mineralit te kromit ne kete objekt dhe ndikimeve pasuese mjedisore ne te, nuk do te kete dhe nuk priten ndikime ne shendetin e popullsisë se zones dhe punonjesve te saj. Per pasoje nuk priten zhvendosje te tyre per shkak te ketij aktiviteti.

19. Ndikimi ne qarkullimin dhe transportin

Aktiviteti i transporti qe do te kryet nga subjekti i shfrytezimit nuk e rendon trafikun aktual ne rrugen qe shkon nga objekti drejt imipantit te pasurimit ne Bater, mbasi numuri i kamionave qe do te kalojne ne te eshte i vogel .

e. Informacioni për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar;

Per fazen e instalimit, nga ana e investitorit do te behet e mundur qe kohezgjatja te jete sa me e shkurter qe te jete e mundur. Pra me masat e parashikuara me siper, mendohet qe ndikimet ne mjedis te jene gati zero ne shtrirjen ne kohe. Si u theksua ashje s' do te shkarkohet ne toke, uje apo ajer.

f. Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;

Gjatë fazës së shfrytëzimit me galeri shkëmbi tokëformues me interes mineral do të nxirret nga nëntoka në sipërfaqe. Ndikimet e mundshme negative lidhen me ndryshimet në strukturën e nëntokës dhe dëmtimin e saj për llogari të nxjerrjes së mineralit. Si pasojë e plasjeve dhe germimeve struktura e nëntokës mund të pësojë çarje ose shëmbje. Por sipas raportit teknik të paraqitur nga kompania, paneli i kërkuar për shfrytëzim nuk formon hinka në sipërfaqe dhe nuk krijon zona rreziku në asnjë pikë të fushës minerare.

Nga ana tjetër ndikimi në strukturën e nëntokës është lidhur direkt me volumin e prodhimit. Për arsye sigurie gjatë fazës së shfrytëzimit do të merren të gjitha masat teknike dhe organizative për forcimin e galerive dhe parandalimin e shembjeve.

Ndikime të tjera në sipërfaqen e tokës të lidhura me këtë fazë janë ngjeshja e tokës nga lëvizja e makinerive, erozioni i tokës përreth zonës së hapjes së galerisë dhe përgjatë rrugëve në zonë, ndotja e tokës nga lubrifikantët e makinerive.

g. Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;

Rehabilitimi mjedisit të ndikuar është akti i restaurimit të mjedisit për ta kthyer atë në gjendjen origjinale, para ndikimeve në këtë rast nga zbatimi i projektit. Nëpërmet rehabilitimit synohet mbrojtja e cilësive natyrore të trashëguara të mjedisit, mbrojtja e shendetit të punonjësve, mbrojtja e cilësisë së ujrave nëntoksore e sipërfaqësore, mbrojtja së cilësisë së tokës, ajrit, garantimi i një zhvillimi të qëndrueshëm në harmoni me mjedisin. Kthimi i mjedisit në gjendje të mëparshme është një proces që përfshin zbatim masash e veprimesh që bëjnë përgatitjen e sistemimit të terrenit të ndikuar, për parandalimin e erozionit, të ngjeshjes së metejshme të tokës, për gjelbërimin e rigjelbërimin, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në mënyrë të vazhdueshme që garanton shendetin e mjedisit. Masat rehabilituese të përcaktuara në planin të rehabilitimit zbatohen duke kryer punime që adresojnë kërkesat teknike si dhe ato estetike e ekologjike. Sistemimi i sheshit të ndertimit të objektit është ngushtësisht i varur nga kërkesat teknike inxhinierike të këtij objekti, distancat e sigurisë, efektiviteti i përdorimit racional të tokës në vartësi të parametrave teknik të projektit. Nderhyrjet rehabilituese brenda sheshit lidhen ngushtë me respektimin e kushteve teknike inxhinierike të projektit. Shtresezimet e sipërfaqësore të sheshit midis elementeve të ndertimit të objektit, koridoret qarkulluese e të shërbimeve të mirembajtjes duhet të respektojnë rigorozisht kushtet teknike. Zona periferike jashtë sheshit është sipërfaqe me aktivitet bujqësor, si dhe rruga hyrese duhet të restaurohet në rastin e ndikimeve të paevitueshme. Po kështu duhet të vepohet me të gjithë elementet jashtë objektit që mund të jenë ndikuar. Parashikimi i gjelbërimit në objekt nga projekti, si dhe rishikimi i gjelbërimit për shtimin e tij në të gjitha anët e objektit duhet të bëhet për të plotësuar sa më maksimalisht kërkesat përmirësuese e restauruese estetike dhe ekologjike por dhe për zbutjen e ndikimit nga zhurmat e stallës dhe aromave të pakëndeshme. Llojet bimor që përdoren për rritjen e vlerave estetike mjedisore rurale janë në vartësi të volumit të kurores vegetative të llojit, anës dekorative që prezanton si dhe dendësisë së përdorimit të llojit. Nga vëzhgimi i llojeve të zonës, mund të aplikohet mbjellja e plepit, shëlgut, frashërit, por dhe e bimeve perhere të gjelberta si tuja, ilqja, dafina etj.

*Sistemimi i terrenit të ndikuar dhe përgatitja e vendit.

Nderhyrja e parë që bëhet për rehabilitimin e vendit është sistemimi i tij, dhe siguri e ruajtja e vendit nga mosdemtimi, gjatë punimeve rehabilituese.

*Masat e sugjeruara

Punimet e pastrimit e sistemimit të vendit pas përfundimit të ndertimit të objektit ndertimor përfshijnë:

- Largimi i të gjitha pajisjeve e mjeteve që kanë shërbyer gjatë procesit ndertimor e instalimeve në objekt.
- Largimi dhe administrimi i përshtatshëm i të gjitha mbetjeve inerte nga territori që rehabilitohet dhe çdo lloje mbetje tjetër në qofte se nuk është trajtuar apo neglizhuar.
- Marrja e masave në pengimin e qarkullimit të lirë të njerezve e kafshëve deri në rahabilitimin e plotë të zonës.

Përdorimi i bimësisë si pjesë e projektit është ndikimi më potencial në krijimin e një ekulibri të stabilizuar rural e bujqësor me funksion të shumfishtë ripërtritës e me ndikime direkte në përmirsimin e treguesve mjedisor. Ndikim të rëndësishëm ka në përmirsimin e vlerave pejsazhiste, duke përmirësuar aspektin pamor dhe duke ndikuar njëkohësisht në zbutjen e ndikimeve të tjera.

*Masat e sugjeruara

- Përdorimi i bimeve gjithnjë të gjelberta e që të përshtatet me kerkesat estetike, ekologjike e mjedisore në tëresi dhe që garanton suksesin e përmirimit të pejsazhit rural.
- Përdorimi i nje shtrese me matërial të tillë që të ndaloje mbirjen e barerave të këqija rreth fidaneve, ruajtjen e për ruajtjen e lageshtirës.

*Mbjellja e fidaneve

Mbjellja behet me anë të fidaneve të prodhuar ne fidanishte të llojeve autokton e ato që përshtaten kushteve të tokës e klimës. Skemat e mbjelljes të llojeve behen duke respektuar dendesinë e lejuar si dhe kombinimet e llojeve.

*Mirëmbajtja

Punimet për mirëmbajtjen lidhen me shërbimet që kërkojnë rritja e bimesisë për plotësimin e kerkesave për ujë, element ushqyes, krasitje, pastrim etj. Në mënyrë të veçantë do të bëhet menjëherë zëvendësimi i fidaneve që rezultojnë të deshtuara në mbirje ose që zhvillohen të dobët në krahasim me pjesën tjetër.

*Monitorimi

Monitorimi lidhet me të gjithë aspektet e mbarvajtjes së nderhyrjeve rehabilituese për të garantuar suksesin e saj. Inspektimet e vazhdueshme në lidhje me zenien e fidaneve e të gjendjes së vegjetacionin në tëresi do të shërbejnë për marrjen e masave të menjëhershme të vijshmërisë së sukseseshme të rehabilitimit.

Masat kryesore për zbutjen e ndikimeve negative në të gjitha fazat e zbatimit të projektit si dhe të funksionimit, janë të paraqitura në tabelen në vijim ku janë patrashtuar edhe kostot e përafërta financiare. Masat e identifikuar ju referohen praktikave më të mira rehabilituese si pjesë e planit të menaxhimit mjedisor në tëresi ku kostot e vlerësuar përfshihen në kostot e zbatimit të projektit.

Veprimtaria	Efektet potenciale	Plani i minimizimit e zbutjes se ndikimit	Pergjegjesia	Kosto e përafert ne \$
Pastrimi e pergatitja e vendit ku zbatohet projekti	Ngjeshje e demtimi i struktures se tokes se zones ne afersi	Rrethimi i sheshit te ndertimit. Ndalimi i nderhyrjeve te panevojshme ne afersi. Krijimi i sektorit te punimeve brenda sheshit dhe spostimet e nevojshme sipas kerkesave teknike e zhvillimore te objektit. Vendorsja e tabelave sinjalizuese	Zhvilluesi	100 (pa elementet e sektorit)
Sistemimi i vendit te punes	Presioni ne sistemin drenazhues dhe erozionin e tokes	Berja e zbatimi i nje plani drenazhimi per mbrojtjen e tokes nga erozioni dhe evitimi i pellgjeve me uje.	Zhvilluesi	800
Hapjet e themeleve	Emetime ndotese ne ajer	Levizja e evadimet e dherave te behen ne kushtet e lagjes per uljen e pluhura. Sperkatja e herepas-hershme e stoqeve, mbajtja e mjedisit paster.	Zhvilluesi	600
Punimet e ndertimit	Ndikimi me zhurmat e vibrimet	Pajisjet e ndertimit duhet te jene sipas Direktivave Standarteve te Komunitetit European 2000/14/EC, Maj. 2000. Kjo direktive aplikohet tek prodhuesit e pajisjeve qe gjenerojne zhurma. Te gjitha pajisjet duhet te mbahen ne kushte te mira.	Zhvilluesi	Te vogla
Largimi i mbetjeve nga pastrimi i terrenit	Ndotja e ajrit, Ndikim ne ndotjen e tokes	Perdorimi i mbetjeve nga pastrimi e hapja e themeleve, per mbushje. Sigurimi i paisjeve personale	Zhvilluesi	800
	Ndikimi ne shendetin e punonjesve	mbrojtese nga pluhurat. Evitimi i shpejtesive te panevojshme te automjeteve		
Punimet operatore ne objekt	Mungesa e vegjetacionit	Rishikimi i projektit per gjelberimin ne te gjitha anet e objektit. Mirembajtja.	Studio projektuese Zhvilluesi	2500
Punime operatore	Rreziku i demtimit te infrastruktures.	Mirëmbajtja e riparimi i menjehershme sipas rastit.	Zhvilluesi	600 (gjate ndert).
Prodhimi i mbetjeve te rrezikshme si dhe ujrave te zeza gjate operimit e funksionimit	Ndotja e tokes, e ujrave siperfaqesore e nentoksore	Hartimi i planit të menaxhimit të mbetjeve. Sigurimi i marrveshjeve per perdorimin e plehut te stalles e ujrave te perdorura. Marrveshjet e kontratat me subjektet sipas rastit. Perdorimi i gropes septike per ujrave te zeza e evadimi i pershtatshem.	<ul style="list-style-type: none"> • Zhvilluesi • Fermeret • Subjektet qe kryejne sherbime 	1500 (nga zhvilluesi gjate ndertimit e funksionit)

h. Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;

-Kushtet e punes

Investitori do te krijojë kushte te favorshme pune per punonjesit e tij. Per te permbushur sigurine e punetoreve ofron kushte te mira pune, ambjent te bollshem dhe duke perdorur lende te kontrolluara dhe pa efekte anesore. Punetoret jane te pajisur me uniforma dhe maska gjate proceseve te punes, zbatohet me rigorozitet rregullorja e higjenes se vendit te punes. Stafi eshte me eksperience ne kete fushë. Jane marre masa per sigurimin teknik ne kantierin e ndertimit.

-Mbrojtja nga zjarri

Ne zbatimin e gërmes b, të nenit 34, të Ligjit Nr.8766 datë 05.04.2001 "Për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpetimin", do të merren masat e nevojshme për mbrojtjen në raste rreziku apo rënie zjarri. Për një siguri maksimale në ambientet e punës nga drejtuesit e saj, do të merren të gjitha masat për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes nga zjarri.

Brenda objektit do të vendosen në vende të dukshme pajisje të mbrojtjes nga zjarri, si dhe do të merren masa për të kryer instruktimin e punonjësve në mënyrë periodike.

Për mbrojtjen nga Zjarri do të merren masat e mëposhtme:

Do të ketë fikese zjarri me kapacitet 50 kg (pluhur fosil dhe gaz karbonik).

Do të ketë një depozite uji

Do të ketë rregullore të brendshme për mbrojtjen ndaj zjarrit.

Personeli do të instruktohet me rregullat e mbrojtjes ndaj zjarrit.

Hyrja për në objekt do të ketë hapësirë të konsiderueshme për automjetet e zjarrfikeseve.

-Vlerësimi i efektivitetit të pritsëm të masave zbutëse

Realizimi i objektivave dhe treguesve të pritsëm të parashikuar në projekt do të varet nga respektimi i të gjithë treguesve të përcaktuar. Kontrolli, monitorimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve të punës do të çojnë përfundimisht në përfundimin e pamjeve të parashikuara në projekt, me sipërfaqe të pastra, të sistemuara dhe të gjelberuara.

i. Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë);

Projekti do të zhvillohet brenda kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe nuk ndodhet pranë kufijve, pra përjashtohet fakti që të ketë ndikime në mjedisin ndërkufitar.

j. Kopje të certifikatës së specialistit/ëve për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor, që ka hartuar raportin paraprak të VNM-së.

Ky raport u hartua nga Eksperti Mjedisor i licensuar nga Ministria e Mjedisit, Remzi Pupli, bashkëngjitur nënshkrimi, vula dhe licensa.

Hartoi:

Ing. Remzi Pupli